



Republika e Kosovës

Republika Kosova / Republic of Kosovo

Agjencia kundër Korrupsionit

Agencija protiv Korupcije / Anti-corruption Agency

**RAPORT MBI ZBATUESHMËRIN E PLANIT TË
VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT
PERIUDHA: SHKURT – MAJ 2013**

PRISHTINË, KORRIK 2013

PJESA E PËRGJITHËSHME

Strategjia kundër korrupsionit dhe plani i veprimit 2013-2017 janë dy dokumente të unifikuara dhe harmonizuara të politikave anti korrupsion të cilat janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në fillim të këtij viti, dhe është finalizim i një procesi hartues disa mujorë i udhëhequr nga Agjencia kundër Korrupsionit si mekanizëm përgjegjës si për përgatitjen ashtu edhe për monitorimin e zbatimit dhe tyre.

Instrumenti kryesor për zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit është Plani i Veprimit.

Në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe të veçanta të themeluara për secilin sektor prioritar, përfshirë këtu edhe prioritetet si horizontale dhe vertikale të Strategjisë, Plani i Veprimit është projektuar për të zbatuar këto objektiva përmes masave specifike dhe konkrete kundër korrupsionit. Ai përbëhet nga objektivat specifike të plan-veprimit (57) dhe masat (176), së bashku me treguesit e suksesit (362) të prekshëm dhe afatet kohore të qarta dhe realiste. Kur afatet janë treguar si "në vazhdimësi", kjo nënkupton se progresi në masa të tilla është menduar të shqyrtohet në baza vjetore, në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

AKK është përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të Strategjisë nëpërmjet masave të parashikuara në Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit

AKK, në bashkëpunim me pikat e kontaktit në çdo institucion përkatës, brenda 30 ditëve nga miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit ka miratuar planin e detajuar të punës për zbatimin vjetor të secilës masë. Ky plan pune duhet të bëhet pjesë integruese e planit vjetor të punës të secilit institucion dhe të miratohet nga Kryetarët e institucioneve përgjegjëse.


Për këtë periudhë raportuese AKK dhe pikat e saj të kontaktit janë përqendruar vetëm në masat e marra pa e future edhe efektet e tyre. Në të ardhmen AKK do të përgatisë raportet jo vetëm sasior por edhe cilësor të monitorimit të bazuar në indikatorët e suksesit të identifikuar në Planin e Veprimit.

Në vazhdim do të gjeni masat që institucionet e ndryshme kanë marr kundër korrupsionit dhe që i reflektojnë masat e parapara në Planin e veprimit. Për shkak të periudhës së shkurtër kohore ky raport prezanton vetëm masat e raportuara nga pikat e kontaktit, ndërsa në të ardhmen Agjencia do ta bëjë edhe analizën e cilësisë së masave të marra dhe efektet pozitive që ato sjellin në dobi të aktiviteteve anti - korrupsion.

MONITORIMI

Me 27 maj 2013, Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) kërkoi nga pikat e kontaktit¹ të përfshira në Planin e Veprimit që deri më 5 qershor 2013 të paraqesin raporte mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2013-2017. Në procesin e raportimit kanë qenë të përfshirë institucionet qendrore dhe lokale publike, sektori privat dhe shoqëria civile.

Për periudhën raportuese, shkurt - maj 2013, Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017 ka dhënë një total prej 154 veprimeve. Institucionet përgjegjëse gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kanë raportuar fare për 56 veprime ose në përqindje 36%. Për 98 veprime të tjera të raportuara nga institucionet dhe në bazë të raporteve të marra, AKK ka nxjerr një përfundim se 40 veprime janë realizuar apo janë në realizim e sipër ose 26%, 21 veprime janë pjesërisht të realizuara ose 14% dhe 37 veprime janë të pa realizuara ose 24%, siç janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Më poshtë gjeni tabelën e Pikave të Kontaktit që kanë raportuar dhe nuk kanë raportuar në lidhje me zbatimin e objektivave dhe veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit për periudhën 11 shkurt - 27 maj 2013.

¹ Pika e Kontaktit - është person përgjegjës i cili raporton në AKK për Institucionin nga i cili vjen.

Pikat e Kontaktit që kanë raportuar për periudhën Shkurt - Maj 2013	Pikat e Kontaktit që nuk kanë raportuar fare për periudhën Shkurt - Maj 2013
<ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 3. Policia e Kosovës 4. Organi shqyrtues i Prokurimit Publik 5. Zyra për Qeverisje të Mirë 6. Agjencia Qendrore e Prokurimit 7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës 8. Dogana e Kosovës 9. Auditori i Përgjithshëm 10. Administrata Tatimore e Kosovës 11. Ministria e Shëndetësisë 12. Inspektorati Policor i Kosovës 13. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal 14. Ministria e Administratës Publike 15. Ministria e Drejtësisë 16. Ministria e Financave 17. Kuvendi i Kosovës 18. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 19. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë 20. Agjencia Kosovare e Privatizimit 21. Prokuroria e Shtetit 22. Agjencia kundër Korrupsionit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni i Pavarur i Mediave 2. Organizata “FOL” 3. Organizata “KDI” 4. Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës 5. Oda Ekonomike 6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Tabela në vijim është hartuar me qëllim të paraqitjes së zbatimit të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017 për periudhën raportuese shkurt-maj 2013, raporti është përmbledhje e të dhënave të pranura nga pikat e kontaktit, ku kategorizimi i veprimeve është bërë në baza të vlerësimit të AKK brenda kësaj periudhe raportuese.

**RAPORTI I DETALIZUAR NË LIDHJE ME ZBATIMIN E VEPRIMEVE KUNDËR KORRUPSIONIT
NGA PIKAT E KONTAKTIT PËR PERIUDHEN SHKUR - MAJ 2013**

Nr.	Emri i Institucionit	Veprimet e planifikuara	Veprimet e realizuara	Veprimet pjesërisht të realizuara	Veprimet e pa realizuara	Veprimet e pa raportuara
1.	Zyra për Qeverisje të Mire	14		2	4	8
2.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	9	2	1	5	1
3.	Këshilli Prokurorial i Kosovës	8	1		1	6
4.	Agjencia Kosovare e Privatizimit	3	1	1		1
5.	Kuvendi i Kosovës	5		1	3	1
6.	Agjencia kundër Korrupsionit	9	5	1	3	
7.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	8		2	1	5
8.	Ministria e Administratës Publike	12	7	1	3	1
9.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2		1	1	
10.	Administrata Tatimore e Kosovës	7	4	1	1	1
11.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Tokologjisë	6			6	

12.	Ministria e Shëndetësisë	5	1	3	1	
13.	Policia e Kosovës	10	4		2	4
14.	Ministria e Drejtësisë	9	5	1	2	1
15.	Inspektorati i Kosovës	2	1			1
16.	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	3	1	1		1
17.	Doganat e Kosovës	1	1			
18.	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	6	4	2		
19.	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik	4			2	2
20.	Ministria e Financave	1				1
21.	Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik	1	1			
22.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	7	2	3	2	
23.	Komisioni i Pavarur i Mediave	2				2
24.	Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës	2				2

25.	Oda Ekonomike	5				5
26.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3				3
27.	Shoqëria Civile	10				10
	Organizata "FOL"					
	Organizata "KDI"					
	Gjithsej :	154 Veprime të planifikuara	40 Veprime të realizuara	21 Veprime pjesërisht të realizuara	37 Veprime te pa realizuara	56 Veprime te pa raportuara

Kjo tabel prezanton emrin e institucionit numrin i veprimeve të planifikuara, numrin i veprimeve të realizuara, veprimet, pjesërisht të realizuara, numrin i veprimeve të perealizuara, si dhe veprimet e pa raportuara

REKOAMNDIMET PËR PIKAT E KONTAKTIT

Nga vlerësimi i zbatimit të objektivave dhe veprimeve që dalin nga plani i veprimit kundër korrupsionit për periudhën shkurt - maj 2013, mund të nxirret këto rekomandime në vazhdim, të cilat do të duhej të merren parasysh nga pikat e kontaktit me rastin e raportimit në periudhat e ardhshme.

- Kërkohet nga të gjitha subjektet raportuese përgjegjësi më e madhe dhe angazhim i fortë për të zbatuar objektivat dhe masat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017
- Pikat e kontaktit të cilat nuk kanë raportuar (KPM, FOL, KDI, AGPK, OE, KQZ,) duhet të raportojnë, sepse AKK pret angazhim pro aktiv të gjithë subjekteve të përfshira në këtë plan kombëtar kundër korrupsionit.
- Një numër i konsiderueshëm i veprimeve të përfshira në planin e veprimit nuk janë realizuar nga ana e institucioneve përgjegjëse (p.sh MASHT etj), në këtë drejtim do të duhej një planifikim më i mirë i veprimeve në mënyrë që ato të realizohen në kohë dhe në mënyrë kualitative.
- Gjatë raportimit duhet të merret parasysh matrica e raportimit dhe të plotësohet siç duhet nga pikat e kontaktit, përndryshe nëse nuk përfillet kjo matricë në raportimet e ardhshme atëherë nuk do të merret parasysh fare

raportimi nga pika e kontaktit (gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është marrë parasysh matrica e raportimit nga këto pika të kontakti: Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Doganat e Kosovës)

- Duhet të ketë raportim më cilësor nga ana e pikave të kontaktit në mënyrë që të maten rezultatet e veprimeve të përfshira në planin e veprimit dhe ndikimi i tyre në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.
- Do të duhej të raportohet në mënyrë më të detajuar lidhur me ndikimin e secilit veprim në zvogëlimin e rreziqeve brenda institucioneve dhe më gjerë.
- Institucionet do duhej të tregojnë se deri në çfarë mase janë zbatuar veprimet dhe a është përmbushur në tërësi qëllimi i tyre. Nëse jo, atëherë këto veprime duhet të rishikohen, ose të plotësohen me veprime të tjera.

Raportimi i ardhshëm nga pikat e kontaktit, në lidhje me zbatimin e objektivave dhe veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017, do të jetë në fund të vitit 2013.